

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE


> IPK.RKS-GOV.NET



**IPK SHKËMBEN PËRVOJAT ME AGJENCINË
MBIKËQYRËSE POLICORE NË REPUBLIKËN E IRLANDËS**

INTEGRITETI

INTEGRITET DHE ETIKË



Revistë e Inspektoratit Policor të Kosovës >> Nr. 8, Viti VI / 2018

INTEGRITETI

INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE



> IPK.RKS-GOV.NET



Garda Ombudsman
INQUIRY INDEPENDENCE IMPARTIALITY



MBIKË

IPK SHKËMBEN PËRVOJAT ME AGJENCINË
MBIKËQYRËSE POLICORE NË REPUBLIKËN E IRLANDËS

info

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista "Integriteti" është
botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun
dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati policor I kosovës

Kryeredaktor:
Arbër BEKA

Ndihmës Redaktor:
Arben Vrajolli

Tel: +377 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI

4

Vazhdon përkrahja
e SHBA-ve për
IPK-në Ambasadori
amerikan
Greg Delawie
vizitoi IPK-në



PËRMBAJTJA

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I PK-SË VIZITOI IPK-NË, 5

INSPEKTIMI PËR MENAXHIMIN
E BURIMEVE NJERËZORE NË PK
KONSTATON MUNGESËN E 130
GRADAVE, 8, 9, 10, 11

KALENDARI 2019, 12, 13

IPK JEP INFORMACIONE PËR
ROLIN DHE MISIONIN E SAJ
QYTETARËVE NË ZVEÇAN, 16

IPK NJOFTON TË RINJTË PËR
MISIONIN E SAJ, 17

IPK SHËNOI PËRVJETORIN
E 12-TË TË THEMELIMIT, 18

IPK VAZHDON
BASHKËPUNIMIN ME EPAC, 19

MISIONI I OSBE-SË
PËRKRAH IPK-NË NË FUSHA
TË NDRYSHME, 20

IPK PJESË E KONFERENCËS
RAJONALE KUNDËR
KORRUPSIONIT, 21

IPK NDAN MEDALJE PËR
ZYRTARËT E ADMINISTRATËS, 23

KRYESHEFJA KELMENDI
MORI PJESË NË KONFERENCËN E
IAWP-SË, 23

6-7

IPK

shkëmben përvojat
me agjencinë
mbikëqyrëse
policore në
Republikën e Irlandës



14-15

Projekti i KiE-së
përkrah IPK-në
për analizën
e nevojave të
trajnitimit



22

Në aksip filloi
trajnimi i gjeneratës
së re të IPK-së



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet,
këndvështrimet e shprehura
ose të përfshira në përmbajtje
të këtij botimi nuk paraqesin
medeomos politikat ose
vështrimet zyrtare të IPK-së.



VAZHDON PËRKRAHJA e SHBA-ve për IPK-në

Ambasadori amerikan Greg Delawie vizitoi IPK-në

Ambasadori amerikan z. Greg Delawie së bashku zyrtarë të lartë të ICITAP-it, u takuan me Kryeshefin Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës znj. Miradije Kelmendi dhe bashkëpunëtorët e saj.

Me këtë rast Ambasadori Delawie e përgëzoi znj. Kelmendi për përzgjedhjen e saj në pozitën e Kryeshefit të IPK-së dhe i uroj suksese në punën e saj. Ambasadori Delawie konfirmoi mbështetjen e mëtutjeshme të Ambasadës Amerikane për Inspektoratin Policor të Kosovës në veçanti dhe në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Kryeshefja e IPK-së falënderoi Ambasadorin Amerikan për vizitën dhe përkrahjen në



vazhdimësi që Ambasada përmes ICITAP-it po jep për Inspektoratin Policor të Kosovës. Ajo tha se do të angazhohet maksimalisht në rritjen e profesionalizmit në IPK dhe ruajtjen e integritetit të Policisë së Kosovës.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM i PK-së vizitoi IPK-në

Drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Rashit Qalaj më bashkëpunëtorë, u takuan me Kryeshefin Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës-së znj. Miradije Kelmendi. Me këtë rast z.Qalaj e përgëzoi znj. Kelmendi për përzgjedhjen e saj në pozitën e Kryeshefit të IPK-së dhe i uroi suksese në punën e saj.

Kryeshefja e IPK-së znj. Kelmendi falënderoi z.Qalaj për vizitën dhe bashkërisht u dakorduan për vazhdimin dhe forcimin e bashkëpunimit mes Policisë dhe Inspektoratit Policor.

Bashkëbiseduesit në këtë takim u pajtuan se rritja e profesionalizmit dhe integritetit të zyrtarëve policorë është prioritet i përbashkët për të pasur një Polici të përgjegjshme, profesionale dhe në shërbim të qytetarëve si dhe për angazhim maksimal dhe luftë të pa kompromis ndaj dukurive negative që mund të shfaqen në Policinë e Kosovës si institucioni kryesor përgjegjës për sigurinë e qytetarëve.



Kryeshefja e IPK-së znj. Kelmendi falënderoi z.Qalaj për vizitën dhe bashkërisht u dakorduan për vazhdimin dhe forcimin e bashkëpunimit mes Policisë dhe Inspektoratit Policor.





Garda Ombudsman
INQUIRY INDEPENDENCE IMPARTIALITY

IPK

SHKËMBEN PËRVOJAT ME AGJENCINË MBIKËQYRËSE POLICORE NË Republikën e Irlandës

10 zyrtarë të IPK-së
morën pjesë në
vizitën studimore në
kuadër të projektit të
Këshillit të Evropës

Një delegacion prej 10 zyrtarëve të IPK së duke përfshirë edhe Kryeshefin e IPK-së znj. Miradije Kelmendi kanë realizuar një vizitë studimore tre ditore te institucionet mbikëqyrëse policore në Dublin – Republika e Irlandës.

Kjo vizitë studimore është realizuar në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës që ka të bëjë me avansimin e të drejtave të njeriut te institucionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Gjatë kësaj vizite delegacioni u prit nga Kryesuesja e agjencisë mbikëqyrëse policore - GSOC (Garda Siochana Ombudsman Commission) znj. Mary Ellen Ring dhe përfaqësuesit e dy institucioneve tjera mbikëqyrëse – Garda Inspectorate (Inspektorati i Gardës) dhe Policing Authority (Bord mbikëqyrës policor).

Zyrtarët e IPK-së shkëmbyen përvojat e mira të agjencive mbikëqyrëse policore lidhur me hetimet e ankesave të qytetarëve ndaj sjelljeve të papërshtatshme të policisë, integritetin policor, fushën e inspektimeve, transparencës, llogaridhënies policore dhe të





trajtimin të të drejtave të njeriut gjatë qëndrimit në qendrat e mbajtjes policore.

Zyrtarët e IPK-së ndoqën nga afër prezantimin nga Drejtori i Hetimeve të GSOC, z.Darren Wright mbi Hetimin e Ankesave që përfshijnë pretendimet për keqtrajtimet nga oficerët e policisë gjatë ndalimit Policor duke dhënë shpjegime edhe për disa formularë që plotësohen

nga zyrtarët policorë që janë të angazhuar në qendrat e ndalimit policor.

Prezantim të praktikave të mira gjatë vizitës studimore ka pasur edhe nga Drejtori i Hetimeve të Zyrës së Ombudsmanit të Policisë të Irlandës së Veriut (OPONI) z.Paul Holmes i cili ka shpjeguar për kompetencat e OPONI-t lidhur me hetimin e ankesave që përfshijnë pretendimet për keqtrajtim fizik nga oficerët

e policisë në Irlandën e Veriut si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet OPONI lidhur me hetimet e ankesave historike në Irlandën e Veriut 1968-1998.

Kjo vizitë studimore është realizuar në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës që ka të bëjë me avansimin e të drejtave të njeriut te institucionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



INSPEKTIMI PËR MENAXHIMIN NË PK KONSTATON MUNGESË

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit të IPK-së, për vitin 2018 ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe atë të burimeve njerëzore. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë se Policia ka ndërtuar një strukturë organizative dhe ka kapacitete humane për të kryer detyrat dhe për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara. Menaxhimi i duhur me burimet njerëzore ndikon drejtpërdrejtë në realizimin e detyrave dhe përmbushjen me sukses të objektivave të përcaktuara. Duhet kuptuar se kjo fushë paraqet një nga investimet më të kushtueshme të organizatës policore. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 1 mars 2018, mbi bazën e Programit të miratuar të punës inspektuese të po të njëjtës datë, ka iniciuar inspektim të rregullt për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Policia e Kosovës kanë fuqi Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të aprovuar nga Ministri i Punëve të Brendshme. Kjo Rregullore përcakton fushë-veprimtarinë, funksionet, organizimin, përgjegjësitë, raportimin dhe kapacitetet. Veç Rregullores në fjalë, Lista e Personelit të Autorizuar (më tutje si LPA) paraqet një dokument të rëndësishëm që mbështet Rregulloren dhe përcakton kapacitetet e burimeve njerëzore të Policisë për çdo ndarje organizative brenda saj, numrin e nevojshëm të punonjësve, numrin e gradave dhe pozitave. Me gjithë faktin se Policia është organizatë shumë dinamike, struktura organizative dhe LPA i nënshtrohen rishikimit apo

Inspektimi ka gjetur se Departamenti i Burimeve Njerëzore përmes të Divizionit të Trajnimeve (të PK-së) është përfshirë në procesin vjetor të Identifikimit dhe Analizës së Nevojave për Trajnime, të zhvilluar me përfshirje të gjerë të strukturës policore. Treguesit e performancës tregojnë se janë shtuar fushat e trajnimeve, numri i trajnimeve dhe i pjesëmarrësve për trajnimet e organizuara nga Divizioni i Trajnimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP).

plotësimit. IPK-ja gjatë inspektimit nuk ka gjetur se ekzistojnë kritere të qarta që duhet përmbushur për të ndryshuar LPA-në. Duhet punuar në drejtim të standardizimit të kësaj fushe, përmes përcaktimit të kritereve të qarta që hapin rrugë ndryshimit të LPA-së.

Sipas raportit të inspektimit policia vazhdon të ballafaqohet me mungesa por edhe tejkalim të numrit të punonjësve në disa departamente dhe nevojitet të punohet në atë drejtim që të përmbillet sistemimi i personelit në kuadër të departamenteve siç parashihet me LPA. Kuota e përmbushjes së kapaciteteve me burime njerëzore është e kënaqshme dhe pritet të ngritet me rekrutimin edhe të zyrtarëve të rinj. Edhe ky inspektim ka vënë në pah nevojën e shpërndarjes më adekuate të personelit të graduar, meqë janë konstatuar tejkalime dhe mungesa të të graduarve në pozitat brenda strukturave të departamenteve. Nëse synohet ngritja e kapaciteteve të plota me personel të graduar, nevojitet shtimi i personelit me të gjitha gradat, pasi është konstatuar mungesë e 130 gradave. Janë identifikuar disa njësi ende të pafunksionalizuara të parapara me Rregullore. Lidhur me këtë duhet analizuar nevojat për këto njësi. IPK vlerëson përkushtimin e Policisë në respektimin e diversitetit etnik dhe gjinor, duke iu ofruar hapësirë komuniteteve për të qenë pjesë e organizatës. Në rastet e ushtruesve të detyrave, ka shënuar ngritje numri i rasteve kur janë tejkaluar afatet për ushtrimin e detyrës. Kontrollimi i dosjes për procesin e gradimit të majorëve nuk ka evidentuar ndonjë dobësi evidente. Lidhur me konkurset e brendshme janë evidentuar disa

FIN E BURIMEVE NJERËZORE NGESËN E 130 GRADAVE



Sipas raportit të inspektimit policia vazhdon të ballafaqohet me mungesa por edhe tejkalim të numrit të punonjësve në disa departamente dhe nevojitet të punohet në atë drejtim...

raste kur nuk është respektuar rregulli për përbërjen e paneleve, gjë që duhet eliminuar në të ardhmen. Në disa raste që lidhen me promovimin e zyrtarëve nga komuniteti pakicë, nuk janë respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat mbi marrëdhënien e punës. Policia nuk ka arritur të nxjerrë Katalogun e Personelit i paraparë me planet e organizatës. Sipas mostrës së siguruar të formularëve të vlerësimit të performancës në punë, vërehen

lëvizje pozitive drejt përmbushjes së obligimeve lidhur me këtë fushë.

Inspektimi ka gjetur se Departamenti i Burimeve Njerëzore përmes të Divizionit të Trajnimeve (të PK-së) është përfshirë në procesin vjetor të Identifikimit dhe Analizës së Nevojave për Trajnime, të zhvilluar me përfshirje të gjerë të strukturës policore. Treguesit e performancës tregojnë se janë

shtuar fushat e trajnimeve, numri i trajnimeve dhe i pjesëmarrësve për trajnimet e organizuara nga Divizioni i Trajnimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP). Pjesëmarrja në trajnimet e brendshme sillet në kuotën rreth 75% për të dy vitet radhazi dhe duhet punuar në drejtim të përfshirjes më të gjerë të punonjësve, siç parashihet me Rregulloren për Personel dhe Administratë, që përcakton obligimet për ndjekjen e 40 orëve trajnim të brendshëm. Trajnimet jashtë vendit janë dyfishuar dhe janë zhvilluar në shumë vende të botës. Numri i seminareve, konferencave, takimeve dhe vizitave jashtë vendit janë përgjysmuar si në numër po ashtu edhe në pjesëmarrje. Ngjarjet dhe organizimet e tilla janë mbështetur nga një numër i konsideruar partnerësh ndërkombëtarë. Sipas inspektimit, Policia ka funksionalizuar një pjesë të Sistemit të quajtur 'PRIMS', përmes të cilit menaxhohen informata mbi burimet njerëzore policore në formë elektronike. Edhe pse janë duke u shfrytëzuar një numër i konsideruar

modulesh, është duke u punuar në drejtim të funksionalizimit më të plotë. Në praktikë janë evidentuar disa vështirësi në mënyrën e funksionimit të tij. Shfaqet si imediate nevoja për shtyrjen para të funksionalizimit të plotë të Sistemit PRIMs. Është duke u punuar në vazhdimësi për kompletimin e sistemit të arkivimit elektronik, duke i kushtuar rëndësi edhe sigurimit të kushteve fizike dhe të sigurisë. Mbetet që Departamenti i Burimeve Njerëzore të shtyjë proceset drejt funksionalizimit të plotë të arkivimit elektronik. Lidhur me dhomën e dosjeve, ajo në masë të madhe plotëson kriteret fizike dhe të sigurisë për administrimin e lëndës arkivore.

Raporti i plotë i inspektimit sipas ligjit të IPK-së është publikuar në ueb faqen zyrtare dhe lexuesit e revistës "Integriteti" mund ta gjejnë në këtë link :

<http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/10/Raport-i-Inspektimit-nr-08-2018-Menaxhimi-i-Burimeve-Njerezore-ne-Policine-e-Kosoves.pdf>

Policia e Kosovës ka në fuqi Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të aprovuar nga Ministri i Punëve të Brendshme. Kjo Rregullore përcakton fushë-veprimtarinë, funksionet, organizimin, përgjegjësitë, raportimin dhe kapacitetet.



Rekomandimet e dhëna nga IPK-ja

1.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, që të përcaktojë kritere strikte, të cilat ndikojnë në plotësim-ndryshimin e Listës së Personelit të Autorizuar.
2.	IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që në kohën optimale të plotësojnë pozitën e lira me gradat përkatëse, konform strukturës organizative dhe Listës së Autorizuar të Personelit.
3.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që krahas mundësive për përmbushjen e nevojave me personel si dhe mundësive buxhetore, të bëjë funksionalizimin e njësive të parapara me strukturën organizative dhe Listën e Autorizuar të Personelit, në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të plota operacionale.
4.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që në drejtim të ngritjes së baraspeshës etnike në shërbim, të respektojë në përpikëri të gjitha kriteret, rregullat dhe procedurat e gradimit për zyrtarët policorë, siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ nr. 08/2012 për procedurën e gradimit në Policinë e Kosovës (neni 19, paragrafi 8, 9, 10 dhe 11) dhe Procedurën Standarde të Operimit (PSO-6.02) për gradim në Policinë e Kosovës (Kapitulli XIV-Kriteret e veçanta për ngritjen e baraspeshës etnike në Policinë e Kosovës).
5.	IPK-ja u rekomandon të gjithë udhëheqësve apo drejtuesve të njësive organizative në kuadër të Policisë, Divizioneve, Drejtorive në Departamentin për Shërbime Mbështetëse dhe Drejtorive Rajonale që janë të obliguar për t'u përfshirë në programin për trajnimin e brendshëm konform nenit 99 të Rregullores për Personel dhe Administratë, që të angazhohen aktivisht në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë zyrtarëve të tyre në trajnime të tilla, në drejtim që të kenë, avancojnë dhe rifreskojnë njohuritë e nevojshme për kryerjen me sukses të detyrave.
6.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të përcjellin që Sistemi PRIMs të funksionojë në përputhje me kërkesat operative, në mënyrë që të arrihet qëllimi i lehtësimit të detyrave me anë të funksionalizimit të mirëfillt të Sistemit elektronik.
7.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore që të jetë shtytësi kyç në realizimin dhe vënien në funksion në praktikë të projektit të Arkivimit Elektronik.

INTEGRITETI

JANAR

D	H	M	M	E	P	SH
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

SHKURT

D	H	M	M	E	P	SH
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28		

MAR

D	H	M	M
3	4	5	6
10	11	12	13
17	18	19	20
24	25	26	27
31			

QERSHOR

D	H	M	M	E	P	SH
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

20

GUSHT

D	H	M	M	E	P	SH
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

SHTATOR

D	H	M	M	E	P	SH
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30					

TETO

D	H	M	M
		1	2
6	7	8	9
13	14	15	16
20	21	22	23
27	28	29	30

INTEGRITETI



S

E	P	SH
	1	2
7	8	9
14	15	16
21	22	23
28	29	30

PRILL

D	H	M	M	E	P	SH
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

MAJ

D	H	M	M	E	P	SH
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

19

KORRK

D	H	M	M	E	P	SH
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

R

E	P	SH
3	4	5
10	11	12
17	18	19
24	25	26
31		

NËNTOR

D	H	M	M	E	P	SH
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

DHJETOR

D	H	M	M	E	P	SH
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Projekti i KiE-së për për analizën e nevojave

Projekti i Këshillit të Evropës ‘Avancimi i të drejtave të njeriut në policimin në Kosovë’, i cili është pjesë e programit rajonal ‘Horizontal Facility for Balkans and Turkey’, ka për qëllim që të avancoj mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut nga policia si dhe të fuqizoj sistemin e kontrollimit të pavarur të punës së policisë. Ky projekt ka përkrahur IPK-në që të vlerësoj nevojat e trajnimit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) dhe kapacitetet për të zbatuar prioritetet strategjike. Punëtorja e Parë mbi Strategjinë e Trajnimit për IPK është organizuar në shtator 2018. Si rezultat i konkluzioneve të punëtorisë është themeluar Grupi Punues mbi Strategjinë e Trajnimeve të IPK-së me qëllim që të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave për trajnim në institucion dhe të zhvillojë një strategji trajnimi. Raporti i përgatitur me ndihmën e ekspertëve të projektit të KE-së tenton që të ndihmojë procesin e identifikimit të nevojave për trajnim dhe të informoj Grupin Punues në lidhje me hendekun ndërmjet qëllimeve organizative, gjendjes ekzistuese dhe të propozoj fushat për intervenim. Dy ekspertë ndërkombëtar dhe një lokal kanë ndihmuar dhe mbështetur Grupin Punues për Trajnim të IPK-së.

Aktivitetet e trajnimit fokusohen në arritjen e ndryshimit dhe qëllimi është të bëhet tranzicioni nga një gjendje e caktuar specifike e njohurive dhe shkathtësive në mesin e një grupi të caktuar të njerëzve drejt një gjendjeje që përcaktohet si superiore, e përmirësuar dhe më e



rah IPK-në të trajnimit



Raporti i përgatitur me ndihmën e ekspertëve të projektit të KE-së tenton që të ndihmoj procesin e identifikimit të nevojave për trajnim dhe të informoj Grupin Punues në lidhje me hendekun ndërmjet qëllimeve organizative, gjendjes ekzistuese dhe të propozoj fushat për intervenim. Dy ekspertë ndërkombëtar dhe një lokal kanë ndihmuar dhe mbështetur Grupin Punues për Trajnim të IPK-së



dobishme në kontekst të arritjes së disa qëllimeve të paracaktuara. Vlerësimi i Nevojave për Trajnim rrjedh nga kufizimet me të cilat përballen organizatat në sferat e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve. Në këtë kuptim, ato duhet të dallohen nga faktorë të tjerë që ushtrojnë ndikim mbi funksionimin e organizatave.

Diagnoza e nevojave për trajnim ndihmon për të identifikuar mospërputhjet ndërmjet njohurisë që kanë pjesëmarrësit potencialë në trajnime dhe njohurisë që është e dëshirueshme për disa arsye specifike.

Ekspertët e KE-së për hartimin e raportit për vlerësimin e nevojave të trajnimit në IPK janë mbështetur edhe në Doracakun e EPAC mbi Vlerësimin e Efikasitetit të Trupave Mbikëqyrës të Policisë.

Raporti i analizës së nevojave të trajnimit ka nxjerrë edhe disa konkluzione që do ti ndihmojnë IPK-së në hartimin e strategjisë së trajnimeve.

Një ndër konkluzionet është se Buxheti i IPK-së është relativisht i vogël dhe shumica e shpenzimeve dedikohen për paga dhe mëditje. Sipas raportit Strategjia e trajnimit duhet të mbulojë tematika mbi normat juridike dhe sistemin e ankesave, shkathtësive të hetimit në fusha të ndryshme prioritare për IPK-në, teknika të intervistimit, mbledhjen dhe ruajtjen e provave. Raporti vë në pah se trajnimet duhet të jenë të avancuara mjaftueshëm edhe për të hetuar dhe identifikuar krimet dhe shkeljet nga vetë ekspertët policor që mund të kenë informacione mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë. Trajnimet e avancuara në planifikim buxhetor, menaxhim dhe prokurim duhet të ofrohen për stafin mbështetës dhe pozitat drejtuese. Prioritet duhet kushtuar edhe ofrimit të trajnimeve në strategji të komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun me qëllim të rritjes së vizibilitetit të organizatës dhe ngritjes së vetëdijes tek qytetarët.

Raporti cek se tematika dhe metodologjia e trajnimit duhet të përzgjidhet me kujdes për të shërbyer qëllimeve strategjike të organizatës dhe që inkurajojnë pjesëmarrjen e stafit. Standardet evropiane në policim, të drejtat e njeriut dhe inspektimi janë të preferuara nga stafi individual dhe të rëndësishme për qëllime organizative. Trajnimet rreth hetimit të avancuar duhet të përfshijnë krimet financiare, krimet kibernetike e që janë të nevojshme për qëllime operacionale. Sipas raportit planifikimi i avancuar, vlerësimi dhe analiza e riskut dhe analiza e të dhënave janë thelbësore për performancën organizative.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) përmes Divizionit për informim dhe bashkëpunim ka realizuar shumë aktivitete në fushën e bashkëpunimit me qytetarët, duke prezantuar para tyre rolin, misionin dhe fushë-veprimtarinë e IPK-së.

Synimi i këtyre aktiviteteve është fuqizimi i bashkëpunimit me qytetarë por edhe i ngritjes së vizibilitetit të organizatës lidhur me fushë-veprimtarinë e IPK-së në përgjithësi dhe “Linjës së kaltër” e zyrave rajonale në veçanti.

Një aktivitet i tillë me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë”, është mbajtur me qytetarët e Zveçanit në ndërtesën e Kuvendit Komunal atje ku morën pjesë qytetarë të moshave të ndryshme.

Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me ICITAP –in, Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe Ekipin Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB) në Zveçan.

Gjatë diskutimit të hapur me qytetarë për fushëveprimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), u dhanë shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, inspektimet dhe roli i tyre në ngritjen e profesionalizmit të policisë dhe rëndësinë e integritetit policor.



Qytetarët e Zveçanit morën informacione shtesë edhe për rolin e IPK-së në sundimin e ligjit në Kosovë si dhe për projektin e regjionalizimit të IPK-së respektivisht hapjen e zyrave rajonale në Prizren, Gjiçan dhe Mitrovicën e Veriut që nga viti 2015.

Vlen të theksohet se ky aktivitet është përcjellë me interesim nga qytetarët e kësaj pjese ku edhe janë parashtruar pyetje të cilave u kanë dhënë përgjigje zyrtarët e IPK-së.



IPK jep informacione për rolin dhe misionin e saj qytetarëve në Zveçan





IPK NJOFTON TË RINJTË PËR MISIONIN E SAJ



Në bashkëpunim me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut zyrtarët e IPK-së shpjeguan misionin e IPK-së në komunat e Prishtinës IPK përmes Divizionit për bashkëpunim dhe informim ishte pjesë e panelit diskutues në ciklin e debateve publike të cilat janë mbajtur në nivelin lokal në tri komunat e rajonit të Prishtinës, përkatësisht, Drenas, Obiliq dhe Lipjan. Të pranishëm në këtë panel ishin edhe përfaqësues nga Agjencia kundër Korrupsionit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor.

Këto debate u mbajtën me qëllim të informimit të qytetarëve nga

komunat përkatëse mbi misionin që Inspektorati Policor i Kosovës ka dhe cilat janë sfidat me të cilat përballet sot IPK-ja por edhe të agjencitë e tjera.

Gjatë këtyre debateve me rininë e këtyre komunave u diskutua edhe për rolin e qytetarëve në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Këto debate organizohen në kuadër të fazës së tretë të projektit “Të Rinjtë për Drejtësi” në kuadër të programit “Kërko Drejtësi” që po mbështetet nga National Center for State Courts – NCSC.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve është publikuar edhe videoja promovuese e platformës “Know Your Rights” (Njih të Drejtat Tua).

Know Your Rights (Njih të Drejtat Tua) është një platformë online, me të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka për qëllim të promovojë të drejtat e të rinjve të moshës 16-29 vjeçare, sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

Platforma ofron udhëzime për disa nga të drejtat në fushën e arsimit, shëndetësisë, komuniteteve jo shumicë, punësimit, familjes, sistemit të drejtësisë, punës në komunitet, përfitimet sociale, dhe fuqizimit të rinisë. Në këtë platformë të përfshira janë edhe dy institucionet e tjera si: Inspektorati Policor i Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor ku qytetarët do të kenë mundësi të paraqesin ankesa.





IPK shënoi përvjetorin e 12-të të themelimit

Inspektorati Policor i Kosovës ka shënuar 12 vjetorin e themelimit në një ceremoni të organizuar në të cilën morën pjesë përfaqësues të MPB-së, institucioneve ndërkombëtare në Kosovë si ICITAP-i amerikan, OSBE-ja EULEX-i, agjencive homologe nga Republika e Shqipërisë dhe Maqedonisë etj.

Me këtë rast Kryeshefi i IPK-së znj. Miradie Kelmendi theksoi se Inspektorati Policor gjatë kësaj periudhe ka pasur një progres të vazhdueshëm të zhvillimit si mekanizëm i kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë së Kosovës për të siguruar një polici të përgjegjshme, profesionale dhe demokratike.

“Krahas fuqizimit të kompetencave të organizatës në fushën e hetimit penal, nuk është ndalur edhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe sot ne jemi mbledhur këtu të falënderojmë të gjithë që kanë kontribuar drejt përmbushjes së misionit dhe vizionit të Inspektoratit



Policor të Kosovës” – tha ndër të tjera znj. Kelmendi.

Zëvendës ministri i MPB-së z. Izmi Zeka në fjalën e tij të rastit në këtë ceremoni shprehu gatishmërinë e MPB-së për përkrahjen e IPK-së:

“Si një organi i jashtëm mbikëqyrës për policinë, IPK do të përkrahët që në punën e saj të ketë profesionalizëm, integritet dhe pavarësi të plotë operative” – theksoi z. Zeka duke shtuar se puna profesionale e IPK-së ka fuqizuar në vazhdimësi Policinë e Kosovës.

Një fjalë rasti ka mbajtur edhe përfaqësuesja e ICITAP-it amerikan znj. Kimberly Riffe e cila nga Inspektorati Policor pranoi një mirënjohje për kontributin e vazhdueshëm drejt fuqizimit të IPK-së. Gjatë kësaj ceremonie mirënjohje u ndanë edhe për përfaqësuesit e misionit të OSBE-së dhe misionit të EULEX-it si dhe për një numër të punonjësve të IPK-së.

IPK VAZHDON bashkëpunimin me EPAC

IPK pjesëmarrës në konferencën profesionale të radhës
të EPAC-ut që po mbahet në Rust të Austrisë

Kryeshefi i IPK-së znj. Miradije Kelmendi me bashkëpunëtorë mori pjesë në konferencën profesionale të radhës të EPAC-ut (European Partners Against Corruption – Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit), e cila u mbajt në Rust të Austrisë, 22-24 Tetor 2018.

Në këtë konferencë morën pjesë mbi 30 delegacione të institucioneve të mbikëqyrjes policore dhe agjencie kundër korrupsionit nga shtete evropiane, si dhe përfaqësues nga EUROPOL dhe INTERPOL.

Në kuadër punimeve në konferencë u diskutuan dhe trajtuan tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me fuqizimin e luftës kundër

korrupsionit, fuqizimin e sundimit të ligjit si dhe rritja e bashkëpunimit në mes agjencie të ndryshme të zbatimit të ligjit, sidomos të agjencie mbikëqyrëse policore.

Në kuadër të agjendës së paraparë u mbajtën punëtori të ndryshme që në mes tjerash do të trajtojnë tema si : të drejtat e njeriut në kontekst të luftës anti-korrupsion, integriteti evropian, sistemi i ankesave etj.

Përfaqësuesit e delegacionit të Kosovës në këtë konferencë zhvilluan takime të ndara me shumë delegacione pjesëmarrëse nga shtetet e Evropës me qëllim të njohjes dhe shkëmbimit të praktikave të mira në forcimin e sundimit të ligjit.





Misioni i OSBE-së përkrah IPK-në në fusha të ndryshme

IPK më fundin e këtij viti përmbyll ledhe planin e saj zhvillimor strategjik 2016-2018.

I tërë ky plan tre vjeçar ishte i fokusuar në disa pika të forta që janë vazhdimësi e rrugëtimit të IPK-së si: ofrimi i shërbimeve më afër qytetarit me planifikimin për vazhdimin e projektit të regjionalizimit, duke vënë në pah luftimin e korrupsionit dhe dukurive tjera negative në PK drejt fuqizimit të integritetit policor, fuqizimin e IPK-së (me trajnime të avancuara, me personel shtesë dhe me pajisje të modernizuara) si dhe preventivën ose qasjen proaktive të IPK-së në raport me shkeljet e mundshme disiplinore ose penale të punonjësve të PK-së.

IPK ka filluar me përgatitjet e draftimit të planit të ri zhvillimor strategjik dhe me mbështetjen e OSBE-së është realizuar një punëtori dy ditore në Prishtinë për draftimin respektivisht caktimin e objektivave strategjike për planin e ri strategjik. Gjithashtu, ky mision ka kontribuar në grupe punues me angazhimin e

ekspertëve si dhe ka mundësuar për IPK-në organizimin e një punëtorie tre ditore në Durrës të Shqipërisë për finalizimin e Planit zhvillimor strategjik 2019-2021.

Misionin i OSBE-së në Kosovë ka vazhduar përkrahjen për fuqizimin e IPK-së, duke kontribuar në mënyrë direkte në ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të IPK-së. IPK pritet

të kompletoj dhomën e dëshmimeve konform standardeve të kërkuara, falë një donacioni nga misioni i OSBE-së, projekt i cili është në realizim e sipër.

Misioni i OSBE-së ka organizuar edhe trajnime me ekspertë të kundër krimeve financiarë nga “Guarda di Finanza”, ku kanë marrë pjesë disa hetues të IPK-së.



IPK pjesë e konferencës rajonale kundër korrupsionit

Konferenca Rajonale Kundër Korrupsionit është një ngjarje e nivelit të lartë që Republika e Kosovës ka organizuar në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Pjesëmarrës në këtë ngjarje të rëndësishme ishin përfaqësuesit e vendeve të rajonit dhe organizatave ndërkombëtare në Kosovë si dhe krerët e shtetit, si: Presidenti i Republikës, përfaqësues të institucioneve qendrore të Kosovës, Shefe e zyrës së BE-së në Kosovës dhe ambasadorët e Britanisë së Madhe, Italisë, Zvicrës etj. Edhe Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së znj. Miradije Kelmendi ka marrë pjesë në këtë konferencë e cila u mbajt në Prishtinë dhe është organizuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve të Konferencës përpos agjendës zyrtare znj. Kelmendi ka shoqëruar delegacionet e huaja edhe në aktivitete kulturore si pjesë e programit të Konferencës. Në konferencën dy ditore morën pjesë drejtues të institucioneve relevante nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Moldavia, Turqia, përfaqësues nga organizatat të specializuara ndërqeveritare në nivel rajonal dhe më gjerë (UNDOC, OECD, UNDP), ekspertë ndërkombëtarë nga



sfera e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore për rend dhe ligj, dhe të organizatave të shoqërisë civile.

Konferenca Rajonale Kundër Korrupsionit është e para këtij formati që organizohet në Kosovë dhe synon që të bëhet tradicionale

përmes miratimit të një Deklarate të Përbashkët në përmbyllje të punimeve.

Konferenca ka për qëllim që të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.





NË AKSP FILLOI TRAJNIMI I GJENERATËS SË RE TË IPK-së

Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike ka filluar trajnimi i gjeneratës së re të trajnimit/programit profesional, “Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës”, ku pjesëmarrës janë shtatëmbëdhjetë kadetë.

Në një ceremoni të organizuar me këtë rast të pranishëm ishin Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë Ismail Smakiqi, Miradije Kelmendi Kryeshefe Ekzekutive e Inspektoratit Policor të Kosovës si dhe zyrtarë të lartë nga institucionet e sigurisë publike dhe organizatat ndërkombëtare.

Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë Ismail Smakiqi gjatë fjalimit të tij para kadetëve të IPK-së theksoi, se janë gjenerata e parë që po fillojnë trajnimin bazik të një programi profesional i cili është si rezultat i projektit të binjakëzimit të Komisionit Evropian.

Ai tha se është hera e parë që në Akademia një agjenci fillon trajnimin profesional me program të validuar nga Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve, si rezultat i punës së përbashkët të eksperteve vendor e të projektit të binjakëzimit.

Në fund drejtori Smakiqi iu uroi sukses në përfundimin e këtij trajnimi pjesëmarrësve. Ndërsa Kryeshefja e Inspektoratit Policor të Kosovës Miradije Kelmendi tha se “po shënohet një moment i veçantë pasi është gjenerata e parë që do të trajnohen dhe certifikohen në programe tashmë të njohura dhe validuara nga Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve për pozitën profesionale, Inspektor Policorë.

“Juve ju pret një periudhë e vështirë në të cilën kërkohet angazhim dhe përkushtim i përditshëm, ne presim që ju të përfundoni këtë sfidë me

rezultate të larta dhe pastaj bashkë të punojmë si pjesë e strukturës së Inspektoratit Policor për të rritur efikasitetin dhe profesionalizmin në arritjen me sukses të misionit të rëndësishëm të përcaktuar me ligj”,

përfundoi Kelmendi.

Në fund ajo falënderoi Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe stafin për punën dhe përkushtimin e vazhdueshëm duke ju uruar suksese në arritjen e objektivave.



IPK NDAN MEDALJE PËR ZYRTARËT E ADMINISTRATËS

Në një ceremoni të organizuar në objektin e Inspektoratit Policor të Kosovës u ndanë 10 medalje (për 5 vjet respektivisht 10 vjet

shërbimi në IPK) zyrtarëve të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Fotot si më poshtë japin pamje nga kjo ceremoni.



Kryeshefja Ekzekutive e IPK-së znj. Miradije Kelmendi së bashku zyrtare të larta të Policisë së Kosovës dhe të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike mori pjesë në konferencën vjetore të IAWP-së (International Association of Women Police)- “Shoqata

Kryeshefja Kelmendi mori pjesë në konferencën e IAWP-së

Ndërkombëtare e Grave Police”), memoton “Udhëheqja drejt ndryshimeve” e cila është mbajtur Calgary, Kanada. Në kuadër të kësaj konference morën pjesë me shumë se

40 delegacione të shteteve nga mbarë bota me fokus të veçantë në punën policore në gjithë botën dhe si të gjithë mund të bëjnë ndryshime në komunitetet dhe vendet e punës. Gjatë konferencës u diskutua për: kulturën organizative, respekti dhe ngacmimi, strategjitë hetimore dhe studimet e rasteve, rekrutimi, punësimi dhe mbarëvajtja në punë, lidhshipi, përfshirja e komunitetit, Mirëqenia, etj. Delegacioni nga Republika e Kosovës mori pjesë në këtë ngjarje në sajë të bashkëpunimit dhe përkrahjes nga INL/ICITAP-i Amerikan.





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



0800003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION